

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7903  
E enjte, 10 tetor 2024  
Çmimi 0.50 €

## Bislimi: Kosova po përshpejton reformat për hyrje në BE



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# TË AKUZUARIT NË RASTIN BANJSKA, NJËRI MOHON FAJËSINË, DY TË TJERË NUK DEKLAROHEN

FAQE 4-5



Në Gjykatën Themelore në Prishtinë të mërkurën është mbajtur seanca përgatitore për rastin e sulmit në Banjškë, në të cilën dy të akuzuar, Vladimir

Tolliq dhe Bllagoje Spasojeviq, nuk pranuan të deklarohen për fajësinë në këtë fazë të procesit. Gjykatësi i rastit konstatoi se me ligj ky veprim do të thotë se ata

nuk e pranojnë fajësinë. I akuzuari i tretë i pranishëm në sallën e gjyqit, Dushan Maksimoviq, u deklarua i pafajshëm

### 'JAM I NGUTSHËM, POR I KTHYESHËM', PSD-JA, AKSION SIMBOLIK NË MERDAR

F. 7



### ROHDE: KOSOVA NGA TANI DO TË PËRFAQËSOHET NË CEFTA NGA ZYRTARËT E VET

F. 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## SPORT



### KOSOVA VAZHDON PËRGATITJET PËR NDESHJET E TETORIT, EMERLLAHU KËRKON 6 PIKË

F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## OPINION

### KONGRESI I PARTISË SË MOS - PUNËS, VETËVENDOSJE!

F. 6

Behxhet Sh.  
SHALA -BAJGORA



## AKTUALE




### BE-ja HAP "KORRIDOR AJROR" PËR TË DËRGUAR NDIHMA NË LIBAN

F. 3

### PËRGJIMET E KUSARI-LILËS ME RADOIÇIQIN, KURTI: DO TË SHTOHET LUFTA HIBRIDE NDAJ QEVERISË

F. 3

## EKONOMI



### AKB-ja KUNDËRSHTON LIGJIN E RI PËR TATIMIN NË PRONË

F. 8

### KMDLNJ: RRIJTE KLIENELISTE DHE DISKRIMINUESE E PENSIONEVE

F. 8



## Presidenti i Austrisë u kërkon partive ta zhblllokojnë ngërçin për formimin e qeverisë

VJENË, 9 TETOR - Presidenti i Austrisë, Alexander Van der Bellen, ka thënë të mërkurën se nuk mund t'i kërkojë partisë së ekstremit të djathtë, Partisë së Lirisë (FPO), ta formojë qeverinë e re, edhe pse ajo i fitoi zgjedhjet e përgjithshme, pasi asnjë parti tjetër nuk dëshiron të qeverisë bashkë me të. Prandaj, ai tha se u ka kërkuar asaj dy partive të tjera më të mëdha t'i japin fund ngecjes së bisedimeve.

FPO-ja, e udhëhequr nga Herbert Kickl, i fitoi 29 për qind të votave në zgjedhjet e mbajtura në fund të shtatorit, duke e lënë në vendin e dytë Partinë Popullore Austriake (ÖVP), e cila i mori 26 për qind të votave.

Megjithatë, FPO-ja ka dështuar ta fitojë shumicën në Parlament për ta formuar vetë Qeverinë e re të Austrisë dhe tani i duhet ta formojë një koalicion për ta udhëhequr qeverinë për herë të parë në historinë e vet.

Vetëm ÖVP-ja e ka lënë derën e hapur për koalicion qeveritar me FPO-në, edhe pse ka thënë jo nëse pjesë e qeverisë së re do të ishte lideri i saj Kickl.

FPO-ja ngul këmbë se Kickl duhet të jetë kancelar i ri dhe se çdo koalicion qeveritar pa FPO-në do të ishte "koalicion i humbësve" dhe "shuplakë" për votuesit. "Jemi në një situatë plotësisht të re me një fitues të ri të zgjedhjeve, me të cilin është e qartë se asnjë parti

nuk dëshiron të qeverisë", tha Van der Bellen, i cili mbikëqyr formimin e qeverive, në një fjalim në televizion pas bisedimeve ndaras me të secilin lider të pesë partive parlamentare. "Bisedimet e mia [me liderët e partive] dje dhe pardje e kanë forcuar këtë përshtypje... një ngecje klasike", tha ai, duke shtuar se Kickl i ka thënë se FPO-ja nuk do të udhëheqë qeveri pa të si kancelar. Ai tha se u kërkoj partive të shikojnë se cilat janë koalicionet e mundshme dhe pastaj ta njoftojnë atë. "A e mendojnë vërtet atë që e kanë thënë ata? Unë e di çfarë pritet, natyrisht, por dua qartësi. Qartësi për Austrinë", shtoi ai.



## BE-ja hap "korridor ajror" për të dërguar ndihma në Liban

BRUKSEL, 9 TETOR - Bashkimi Evropian tha të mërkurën se kishte nisur një "korridor ajror humanitar" për të dërguar ndihma në Liban, ndërsa luftimet përshkallëzohen midis Izraelit dhe Hezbollahit, grup militant i përkrahur prej Iranit, dhe parti politike që kontrollojnë pjesën më të madhe në jug të Libanit.

Komisioni Evropian tha se janë planifikuar tri fluturime fillestare për të transportuar ndihma nga Italia dhe Dubai drejt vendit të shkatërruar nga konflikti, me fluturimin e parë që pritet të



mbërrijë në Bejrut të premtën. "BE-ja qëndron pranë njerëzve të

prekur nga kriza në Liban", shkroi në X presidentja e Komisionit

Evropian, Ursula von der Leyen. "Që nga batanijet deri te pakot e strehimit dhe ilaçet. Më shumë ndihma do të vijnë".

Javën e kaluar BE-ja tha se do ta shtonte ndihmën humanitare për Libanin për 30 milionë euro në përgjigje të dhunës në zhvillim. Izraeli ka intensifikuar sulmet ndaj bazave të Hezbollahit në Liban që nga 23 shtatori, duke lënë mbi 150 të vdekur dhe duke detyruar mbi një milion njerëz të largohen. Hezbollahu është shpallur organizatë terroriste prej Shteteve të Bashkuara, derisa Bashkimi

Evropian e ka në listë të zezë krahun e armatosur, por jo partinë politike. Partia politike e Hezbollahit ka ulëse në Parlamentin e Libanit.

Hezbollahu hodhi predha drejt Izraelit të mërkurën dhe tha se kishte penguar inkursionet tokësore, një ditë pasi kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, paralajmëroi se Libani mund të përballë me shkatërrim si Gaza. Brukseli tha se që nga java e kaluar po koordinonte dërgesat e ndihmave për Libanin nga shtetet anëtare: Belgjika, Franca, Polonia, Sllovakia dhe Spanja.

## Samiti për Ukrainën bashkon në Dubrovnik liderët e Ballkanit dhe Zelenskyn

DUBROVNIK, 9 TETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, mbërriti të mërkurën në Kroaci për një samit me liderët e Ballkanit - përfshirë presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, ndërsa vendi i tij përpiqet t'i ndalë avancimet ruse në lindje të Ukrainës, me Kievin që kërkon më shumë ndihmë ushtarake.

Zelensky tha në platformën X se kishte mbërritur në Kroaci për të marrë pjesë në samitin që po mbahet në pjesën jugore të Dubrovnikut.

Samiti do të diskutojë për "përpjekjet ndërkombëtare për ta afruar paqen... si dhe bashkëpunimin në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s", tha ai.

Kroacia do të presë liderët e 12 shteteve rajonale dhe Zelenskyn në këtë udhëtim të tij për të siguruar mbështetje nga aleatët, ndërsa zgjedhjet e ardhshme në ShBA mund t'i lënë nën hije zhvillimet në Ukrainë.

Samiti do të tregojë se "i gjithë

rajoni mbështet Ukrainën dhe popullin ukrainas në luftën për liri", tha kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenković.

Ai premtoi vazhdimin e "solidaritetit me Ukrainën... duke përfshirë ndihmën ushtarake".

Së bashku me Zelenskyn dhe Plenkovićin do të jenë kërret e shteteve, kryeministrat dhe ministrat e jashtëm nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Kosova, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Turqia.

Presidenca e Kosovës ka thënë se në këtë samit "pritet të riafirmohet mbështetja e palëkundur për integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës, rëndësia e sanksioneve kundër Rusisë, bashkëpunimi me BE-në dhe mbështetja e vendeve të Evropës Juglindore për Ukrainën". Ndërsa në margjinat e këtij samiti, Osmani pritet të ketë zhvillime dhe takime të ndara me homologët e saj. Takimi pranë brigjeve të



Adriatikut është samiti i tretë "Ukraina-Evropa Juglindore".

Në samitin e fundit të mbajtur në Shqipëri në shkurt, Zelensky bëri thirrje për mbështetje më të madhe për të ndihmuar në mbrojtjen kundër forcave ruse. Ai vazhdoi të kërkojë më shumë ndihmë, ndërsa Rusia po përfiton

në fushëbetë nga avantazhi me burime njerëzore dhe municione. Zelensky, gjithashtu, kërkoj leje për t'i përdorur armët me rreze të gjatë, që janë dhënë nga aleatët, për të sulmuar objektiva ushtarake thellë brenda territorit rus.

Një deklaratë e përbashkët në

fund të samitit pritet ta dënojë agresionin rus, ta mbështesë integritetin territorial të Ukrainës dhe planin e paqes të Zelenskyn, të kërkojë ndjekje penale për krimet e luftës në Ukrainë dhe ta mbështesë integrimin evropian dhe anëtarësimin në NATO të Kievit, sipas medieve lokale.



## Hamza në Vushtrri: Beteja jonë është me problemet e qytetarëve, të cilët meritojnë mirëqenie më dinjitoze

VUSHTRRI, 9 TETOR - Kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka takuar mësimdhënës, ndërmarrës, studentë dhe njerëz të artit e kulturës në një tubim në qytetin e Vushtrrisë. Njëpërmjet një njoftimi në "Facebook", Hamza tha se "qytetarët meritojnë mirëqenie më

dinjitoze, paga më të larta, ekonomi më të zhvilluar, shëndetësi më të mirë dhe arsim më cilësor". Pasdite e mirë në Kalanë e Vushtrrisë, me bashkëbiseda të singerta me mësimdhënës, ndërmarrës, studentë dhe njerëz të artit e kulturës të kësaj komune. Beteja jonë është me problemet e



qytetarëve, të cilët meritojnë mirëqenie më dinjitoze, paga më të larta, ekonomi më të zhvilluar, shëndetësi më të mirë dhe arsim

më cilësor. Ne do të vazhdojmë të flasim dhe punojmë vetëm për atë që ka rëndësi për qytetarët dhe vendin tonë. Kosova është

shtëpia jonë e përbashkët dhe me përkushtim e punë do ta bëjmë më të mirë!", ka shkruar Hamza.

## "Jam i ngutshëm, por i kthyeshëm", PSD-ja, aksion simbolik në Merdar

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 TETOR - Partia Socialdemokrate (PSD) ka zhvilluar të mërkurën një aksion simbolik në Merdar, një ditë pasi ky pikëkalim kufitar me Serbinë, me vendim të qeverisë, është hapur për kalimin e mallrave serbe.

Anëtarët e PSD-së kanë vendosur një pankartë me fotografinë e kryeministrit Albin Kurti me mbishkrimin "Jam i ngutshëm, por i kthyeshëm".

Policia ka kërkuar nga anëtarët e PSD-së që pankartat t'i vendosin jashtë rrethojave, por një gjë e tillë u kundërshtua nga aktivistët e kësaj partie, me ç'rast pati një përplasje ndërmjet tyre. "I ngutshëm, por i kthyeshëm". Që nga fillimi i kësaj qeverie jemi udhëhequr nga një politikë pa princip, pa koherencë dhe të



pandershme. Kosova është e izoluar me sanksione krahas Bjellorusisë, Venezuelës e Iranit, ndërkohë që po na përvdhet

autonomia. Në krejt këto situata po rritet pensioni për 20 euro, që s'e mbulon as inflacionin e tri viteve të fundit. Kjo nuk është

qeverisje me integritet. Kjo është një qeveri që shkon sipas interesave të pushtetit të një njeriu", ka thënë lideri i kësaj partie, Dardan Molliqaj.

Ai ka thënë se Kurti ka ndërtuar një qasje politike bazuar në iluzione: çdoherë vepron me dy mesazhe të kundërta. "Fillimisht bën një lëvizje të bujshme që duket si rezistencë ndaj presioneve të jashtme - i ashpër, i paepur, sikur nuk bën kompromis. Nuk po kalon shumë kohë, kompromisi po vjen, e mbrapa po e lë dëmin që po shkakatohet, deri të rezistenca e radhës. Pas gjithë këtij teatri populist, humbjet po na shiten si fitore. Kur u vendosën masat për produktet serbe, u tha se ato ishin për arsye sigurie. Po çfarë ndodhi? Pa ndryshuar asgjë në terren, pa asnjë skaner të kërkuar si kriter, kamionët filluan të qarkullojnë. Kjo nuk ka të bëjë me sigurinë

kombëtare. Kjo është frika e një politikani për ta humbur pushtetin. Kur mallrat filluan të qarkullojnë, nuk ishte sepse u përmbushën kriteret e qeverisë, por sepse Kurti rrezikonte përjashtimin nga Procesi i Berlinit", ka pohuar Molliqaj, duke shtuar se ky është modus operandi i Kurtit: ai vepron me një qëndrim të fortë në fillim, krijon një spektakël për të fituar pikë politike, pastaj tërhiqet në momentin kur presioni personal bëhet i padurueshëm. "Kemi parë këtë tek ura në Mitrovicë, po e shohim tek të gjitha proceset që i ka nisur. Në ndërkohë, qytetarët e Kosovës janë ata që po vuajnë pasojat. Pasiguria po bëhet pjesë e përditshmërisë. Kërcënimet për konflikt janë gjithnjë të pranishme. Çmimet janë të larta, projektet kapitale mungojnë, investimet e huaja po na anashkalojnë", ka thënë Molliqaj.

## Përgjimet e Kusari-Lilës me Radoiçiqin, Kurti: Do të shtohet lufta hibride ndaj qeverisë

PRISHTINË, 9 TETOR - Kryeministri Albin Kurti ka folur për përgjimin e radhës që u publikua për shëfën e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, me Milan Radoiçiq, që atëherë ishte nënkryetar i Listës Serbe.

Në një konferencë për medie, Kurti tha se nuk e ka parë e dëgjuar, por vetëm di të thotë që lufta hibride ndaj qeverisë do të shtohet. "Në këto momente nuk kam as si ta shoh e as si ta dëgjoj. Përshtypja ime është se tani do të intensifikohet lufta hibride kundër Republikës së Kosovës, në veçanti kundër qeverisë sonë, kundër grupit tonë parlamentar, dhe kryetares së grupit tonë parlamentar. E kemi parë edhe

në të kaluarën, dhe unë nuk pres shumëçka të re prej atyre të vjetërve të cilët natyrisht problemin më të madh e kanë që sikurse në këto tri vite e gjysmë që ka pasur sundim të ligjit, rend publik dhe integritet territorial, nuk i gjeni asnjëherë në Kosovën e pasluftës", ka thënë Kurti.

Audioincizimet janë publikuar të mërkurën nga portali "Paparaci", derisa çështja ka të bëjë me kalimin e Projektligjit për Pagën Minimale dhe për votimin e një kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në qershor të 2022-s.

Në kohën e komunikimit, Radoiçiqi veç ka qenë në ndjekje të autoriteteve të Kosovës dhe në listën e zezë të ShBA-së. Ai

tashmë ndodhet në arrati nga autoritetet e Kosovës që nga 18 janari 2019 dhe i sanksionuar nga ShBA-ja në dhjetor të vitit 2021.

Komunikimi ishte realizuar me ndërmjetësimin e Sllavko Simiqit, ish-homologut të Kusari-Lilës nga Lista Serbe. Me të nisur biseda telefonike, Simiqi e informon Kusari-Lilën se ka mbërritur "te Millani [Radoiçiqi, v.j]" dhe i sugjeron të dëgjohej direkt me të. "Hej kolege, ja mbërrita te Millani, dhe ja dëgjohu me të", i thotë Simiq, Kusari-Lilës. "Hajde", i përgjigjet Kusari-Lila, shëfët të grupit parlamentar të Listës Serbe. Pasi të dy merren vesh për kycjen në bisedë të Radoiçiqit, Simiq ia



kalon telefonin të fortit të Listës Serbe dhe vazhdon komunikimi. Partia e Kurtit, LV-ja, sa ishte në opozitë i kritikonte pushtetet e

mëhershme për bashkëpunim me Listën Serbe për ligje të caktuara që do të duhej të kalonin në Kuvendin e Kosovës.





## Të akuzuarit në rastin Banjska, njëri mohon fajësinë, dy të tjerë nuk deklarohen

PRISHTINË, 9 TETOR - Në Gjykatën Themelore në Prishtinë të mërkurën është mbajtur seanca përparimtare për rastin e sulmit në Banjskë, në të cilën dy të akuzuar, Vladimir Tolliq dhe Bllagoje Spasojeviq, nuk pranuan të deklarohen për fajësinë në këtë fazë të procesit. Gjykatësi i rastit konstatoi se me ligj ky veprim do të thotë se ata nuk e pranojnë fajësinë.

I akuzuari i tretë i pranishëm në sallën e gjyqit, Dushan Maksimoviq, u deklarua i pafajshëm. "Ai pohon se nuk është i përfshirë në këto vepra kriminale ndaj, në përputhje me rrethanat, do ta parashtrijmë kërkesën për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave", tha avokatja e tij Jovana Filipoviq. Avokati i Spasojeviqit, Lubomir Pantoviq, tha për Radion Evropa e Lirë se të akuzuarit kanë të drejtë ta pranojnë ose ta pranojnë pjesërisht fajësinë në një fazë të mëvonshme.

Seanca e së mërkurës nisi me leximin e emrave të të akuzuarve që ndodheshin në sallën e gjyqit, ndërkohë që prokurori lexoi aktakuzën.

Më 11 shtator Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë kundër 45 personave, të cilët akuzohen për terrorizëm, financim të terrorizmit dhe vepra të tjera të rënda penale, por vetëm tre prej tyre - Tolliq, Spasojeviq dhe Maksimoviq - janë në dispozicion të organeve të drejtësisë.

Pas seancës së sotme mbrojtja i ka 30 ditë kohë për ta apeluar

aktakuzën.

Në seancë nuk u përmend gjykimi në mungesë i të akuzuarve të tjerë.

### Çfarë kanë thënë tre të akuzuarit?

Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Speciale e Kosovës, një prej tre të akuzuarve që gjenden në paraburgim në Kosovë është mbrojtur në heshtje. Një tjetër ka deklaruar në Stacionin Policor të Mitrovicës më 24 shtator 2023, se një ditë më herët ka shkuar në Rashkë, ku është takuar me tre persona (po ashtu të akuzuar), me të cilët, në mënyrë të organizuar me disa vetura, kanë shkuar në Banjskë, ku u janë dhënë uniforma dhe armatim. Atij i është thënë se "do të bëhet një barrikadë me kamion dhe një protestë, për të cilën ka menduar se është paqësore". "Por, pasi ka pranuar uniformën ushtarake-taktike dhe armatimin, aty e ka kuptuar se diçka nuk është në rregull, por se është detyruar t'u bindet urdhrave", thuhet në aktakuzë. Sipas aktakuzës, ai ka thënë se gjatë natës ka qëndruar në një veturë dhe pastaj në afërsi të një ujëvare dhe në mal, dhe se "asnjëherë nuk ka shtënë me armë". Më vonë ai i është dorëzuar Policisë së Kosovës. Ai, po ashtu, ka deklaruar se rreth dhjetë vetura të tipit Jeep pa targa kanë ardhur nga Serbia me rreth 50 persona, shumicën e të cilëve ka thënë se nuk i ka njohur. "Gjithashtu, ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë presion apo

### Koci: Kam informata se në rastin Banjska ka edhe më tepër të përfshirë

Pas përfundimit të seancës së dytë dëgjimore në kuadër të rastit terrorist të Banjskës, para medieve ka folur avokati Arianit Koci, i cili është përfaqësues i familjes së zyrtarit policor të vrarë në këtë rast, Afrim Bunjaku. Ai ka thënë se janë evituar të gjitha pengesat procedurale dhe se tash të akuzuarit i kanë 30 ditë afat për t'i kundërshtuar provat dhe për të bërë kërkesë të hedhjes së aktakuzës. "Prej tre të akuzuarve, dy nuk u deklaruan fare, që do të thotë se nuk e kanë

pranuar fajësinë, i treti tha fare s'kam lidhje me këtë aktakuzë. Unë si përfaqësues i familjes së oficerit të familjes Bunjaku pres që të dënohen të gjithë pasi ka prova të pakundërshtueshme. Kam informacione se janë edhe shumë persona të tjerë të përfshirë, por a do të ngritet një aktakuzë e re apo do të zgjerohet kjo, mbetet në strategjinë e prokurorit. Hetimet për këtë rast në mënyrë të vullshme dhe intensive po vazhdojnë", ka thënë Koci.

kërcënim për të marrë pjesë në këtë grup dhe se vullnetarisht është bërë pjesë e tij...".

Tolliq, Spasojeviq dhe Maksimoviq u arrestuan pas sulmit të armatosur në Banjskë, në veri të Kosovës, më 24 shtator të vitit të kaluar.

Atë ditë një grup i armatosur serbësh sulmoi Policinë e Kosovës dhe vrau policin Afrim Bunjaku. Gjatë shkëmbimit të zjarrit më pas, u vranë edhe tre sulmues serbë. Përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, që ka mbështetjen e Beogradit zyrtar. Besohet se ai dhe shumica e pjesëtarëve të këtij grupi të armatosur ndodhen në Serbi.

Seanca përparimtare ishte paraparë të mbahej më 25 shtator, por avokatët e të arrestuarve kërkuan shtyrje me arsyetimin se kishin marrë aktakuzën me vonesë dhe se u nevojitej kohë për t'u përgatitur. Prokuroria, në anën tjetër, kërkoi që gjykimi të fillojë edhe për të akuzuarit që janë në arrati, gjë që u kundërshtua nga avokatët, duke theksuar se një gjë e tillë nuk parashihet me ligjet e Kosovës. Në fund, gjyqtari i rastit, Arben Hoti, tha se do të kërkojë një opinion juridik nga Gjykata Supreme për interpretimin e ligjit, kur bëhet fjalë për gjykimin në mungesë, dhe konstatoi se ka kushte për t'i gjykuar ata që ndodhen në paraburgim në Kosovë.

Gjykata Supreme konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" se e ka pranuar kërkesën për këtë çështje, më 30 shtator, dhe se lënda po shqyrtohet.

Zyrtarë të saj theksuan se nuk ka ndonjë afat brenda të cilit Gjykata Supreme e Kosovës duhet të japë mendimin e saj juridik.

Prokuroria Speciale e Kosovës i ngarkon të akuzuarit në rastin Banjska, ndër të tjera, për vepra terroriste dhe vepra kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës.

Më herët, prokurori i rastit, Naim Abazi, ka thënë se të akuzuarit kanë pasur role të ndryshme brenda grupit kriminal - nga organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve terroriste deri te financimi dhe pastrimi i parave.

Në aktakuzë thuhet se ky grup, përmes përdorimit të dhunës me armatim të rëndë, ka tentuar "ta shkëpusë pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës, respektivisht komunat e banuara me shumicë serbe, dhe këtë pjesë të territorit t'ia bashkojë Republikës së Serbisë".

Si lider i këtij grupi është identifikuar Millan Radoiçiq, për të cilin thuhet se ka luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin e sulmit dhe aktivitetet kriminale. Radoiçiq gjendet në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar për lidhjet me krimin e organizuar ndërkombëtar dhe korrupsionin. Në Kosovë, ai gjithashtu lidhet me vrasjen e një politikani opozitar serb, si dhe me frikësimin e



## Bislimi: Kosova po përshpejton reformat për hyrje në BE

Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën vendimin për Agjendën e Reformave të Kosovës në kuadër të Instrumentit të BE-së për reforma dhe rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor, e që për objektive ka zbatimin e reformave drejt aderimit në BE dhe atyre për rritje ekonomike



6 shtetet e rajonit si ndihmesë për arrijtjen e reformave, nga të cilat Kosova mund të përfitojë në maksimum 882,6 milionë euro. Këto fonde të destinuar për vendin tonë arrihen në atë rast kur ne i plotësojmë reformat për të cilat jemi dakorduar me Komisionin Evropian. Nga kjo shumë, rreth një e treta apo diku 253,3 milion euro janë grante, kurse pjesa tjetër janë hua afatgjate apo 629,3 milion euro. Kjo nënkupton që këto hua fillojnë të kthehen pas 10 viteve edhe me normë jashtëzakonisht atraktive të interesit dhe kthehen për një periudhë 40-vjeçare. Gjysma e fondeve pasi të zbatohen reformat shkojnë direkt në buxhetin e shtetit si mbështetje direkte buxhetore, kurse pjesën tjetër pastaj e thithim përmes projekteve investive në kuadër të Kornizës Investive për Ballkanin Perëndimor që njihet si "EBIF", ka theksuar ai.

Bislimi ka thënë se negociimin e agjendës së reformave dhe Planit të Rritjes e kanë filluar që nga nëntori i vitit të kaluar përmes ekipit kryesor negociues që ka qenë brenda Zyrës së Kryeministrit dhe agjenda prek shumë fusha, pra në tërësi janë pesë fusha. "Qeverisja, reforma e administratës publike dhe

menaxhimi i financave publike; fusha e dytë ka të bëjë me tranzicionin e gjelbër dhe digitalizimin; fusha e tretë ka të bëjë me zhvillimin e sektorit privat dhe mjedisin e të bërit biznes; e katërta merret me zhvillimin dhe ruajtjen e kapitalit human; dhe fusha e fundit ka të bëjë me vlerat themelore dhe sundimin e ligjit. Në kuadër të këtyre fushave ne kemi dakorduar 30 reformat të cilat pastaj janë operacionalizuar në 111 veprime konkrete të cilat kanë afat zbatimi deri në fund të vitit 2027 dhe për secilën prej këtyre reformave pastaj edhe kemi kostim që nënkupton shumën të cilën Kosova përfiton pas raportimit pozitiv për përmbushjen e këtyre reformave", ka pohuar Bislimi.

Ai ka folur për disa prej reformave që janë dakorduar. "Tek administrata publike kemi forcimin e kapaciteteve administrative, krijimin e një sistemi transparent të kompensimit si dhe organizim më të thjeshtësuar të ministrive të linjës. Te financat publike kemi plotësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për prokurim publik dhe ndërmarrjen e reformave në menaxhimin e investimeve publike. Te siguria kibernetike kemi përafrimin me direktivat dhe standardet e sigurisë të Bashkimit Evropian. Tek eficientia e energjisë kemi zbatimin e Direktivës së Eficiencës së Energjisë dhe Direktivës për Performancën Energjetike të Ndërtesave. Te tregu apo reformat e tregut kemi transpozimin dhe zbatimin e Paketës për Energji të Pastër të Bashkimit Evropian. Te klima e biznesit kemi lehtësimin e investimeve në sektorin privat dhe përmirësimin e mekanizmave për tërheqjen e më shumë investimeve të huaja direkte sidomos në sektorët strategjikë. Do të kemi edhe rritje të qasjes në financa dhe integrim të sistemit të pagesave, për të cilat edhe foli

kryeministri. Tek arsimit do të kemi prezantimin e një sistemi arsimor të digitalizuar duke zbatuar infrastrukturën digjitale nëpër shkollë; synojmë edhe rritjen e regjistrimit dhe cilësisë së arsimit në fëmijërinë e hershme; si dhe rritjen e cilësisë së arsimit dhe profesionit të mesimdhënësit. Te tregu i punës zbatohen politika për rritje të pjesëmarrjes në tregun e punës të grupeve të caktuara siç janë gratë, të rinjtë dhe grupet e cenushme; dhe punojmë drejt përafrimit të arsimit me nevojat e tregut të punës. Te gjyqësori parashohim përmirësimin e performancës, integritetit, llogaridhënies dhe efikasitetit të sistemit tonë gjyqësor. Tek të drejtat themelore kisha veçuar forcimin e zbatimit të kornizës legjislative dhe strategjike për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore si dhe për të drejtat e komuniteteve joshumicë", ka deklaruar Bislimi.

Ai ka bërë me dije se në kuadër të Planit të Rritjes është aprovuar edhe lista e projekteve indikative me të cilat pastaj aplikojnë në Kornizën e Investimeve të Ballkanit Perëndimor. "Po flasim për projekte kryesisht infrastrukturore nga fusha e transportit, energjisë dhe infrastrukturës digjitale. Nga kjo mund të shohim se brenda 4 viteve të ardhshme shumë ndryshime të nevojshme dhe pozitive do të ndodhin nëpër disa sektorë, duke vazhduar kështu rrugën dhe orientimin tonë për zhvillim ekonomik dhe demokratik të shtetit", ka thënë Bislimi.

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 9 tetor - Qeveria ka miratuar të mërkurën vendimin për Agjendën e Reformave të Kosovës në kuadër të Instrumentit të BE-së për reforma dhe rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor, e që për objektive ka zbatimin e reformave drejt aderimit në BE dhe atyre për rritje ekonomike, të negociuara me BE-në.

Në një konferencë për medie, zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi ka thënë se me këtë vendim kanë shënuar një hap shumë të rëndësishëm duke aprovuar agjendën e reformave në kuadër të Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, plan i cili ka për qëllim që rajonin tonë ta sjellë më afër Bashkimit Evropian, duke na ndihmuar në nxitjen e rritjes ekonomike, përshpejtimin e konvergencës socio-ekonomike, si dhe qasjen në tregun unik të BE-së. "Pra, ideja është që të përshpejtohet procesi i arrijtjes së reformave në anën tonë në mënyrë që ta përshpejtojmë edhe hyrjen në Bashkimin Evropian. Për 4 vitet e ardhshme janë bërë të disponueshme nga Komisioni Evropian rreth 6 miliardë euro për

## Rohde: Kosova nga tani do të përfaqësohet në CEFTA nga zyrtarët e vet

PRISHTINË, 9 TETOR - Ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, ka thënë të mërkurën se Kosova do të përfaqësohet nga zyrtarët e vet nga tani në Marrëveshjen për Tregtinë e Lirë të vendeve të Evropës Qendrore (CEFTA). Kosova është përfaqësuar në CEFTA përmes Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) prej vitit 2007, kur iu bashkua asaj. "Lajm vërtet i mirë për Kosovën dhe tërë rajonin: CEFTA është zbllokuar dhe nga tani Kosova do të përfaqësohet nga zyrtarët e vet, ashtu siç duhet, e jo nga UNMIK-u", shkroi Rohde në X.

CEFTA synon rritjen e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, eliminimin e barrierave tregtare mes palëve dhe tërheqjen e investimeve. Ai tha se ky është



"hap i madh" drejt përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së barabartë në këtë organ rajonal. Ky ndryshim, të cilin Kosova ka kohë që e kërkon, erdhi dy ditë

pasi Qeveria e Kosovës vendosi ta heqë ndalesën ndaj importit të mallrave serbe në pikëkalimin në Merdar. Kosova u përball me trysni në javët

e fundit për ta hequr ndalesën ndaj mallrave serbe, posaçërisht nga Gjermania.

Gjermania ka këmbëngulur se ndalimi i importit të mallrave nga Serbia dëmton marrëveshjen CEFTA-s dhe Procesin e Berlinit, një nismë që synon ta ndihmojë zhvillimin ekonomik të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe t'i afrojë ato me Bashkimin Evropian.

I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, qëndroi disa herë në Kosovë në muajt e fundit, ku paralajmëroi se ndalesa e mallrave serbe bllokonte punën e CEFTA-s dhe se, për shkak të saj, Kosova rrezikonte pjesëmarrjen në Procesin e Berlinit. Samiti i dhjetë i Procesit të Berlinit mbahet më 14 tetor.

Pas kërkesës së zyrtarëve të Kosovës për ndryshimin e emrit, Gjermania ofroi një "zgjdhje" në këmbim të heqjes së ndalesës për importin e mallrave nga Serbia. Sarrazin theksoi se pranë emrit të Kosovës në CEFTA do të kishte një yll, ose një fusnotë, që tregon se statusi i Kosovës nuk është zgjidhur përfundimisht.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha të hënën, kur njoftoi për heqjen e ndalesës ndaj mallrave serbe, se pret që Kosova në takimin e radhës të përfaqësohet me emrin e vet. Shtete anëtare të CEFTA-s janë Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi dhe Moldavia. Rumania, Bullgaria dhe Kroacia u tërhoqën nga CEFTA pas anëtarësimit të tyre në BE.

dëshmitarëve në një proces gjyqësor për disa ndërtime ilegale.

Në aktakuzë, Prokuroria përmend 34 dosje me prova, në mesin e të cilave ka video-incizime, analiza të pajisjeve elektronike, përgjigje të ndryshme nga Luksemburgu,

Bosnje e Hercegovina, bankat dhe institucione të ndryshme, deklarata të dëshmitarëve etj. Hetime të sulmit në Banjskë po bën edhe Prokuroria e Lartë Publike në Beograd, e cila e ngarkon Radoiqiqin me tri vepra penale - në mesin e të cilave janë: prodhimi i paautorizuar,

posedimi, mbajtja dhe trafikimi i armëve të zjarrit dhe lëndëve shpërthyes, si dhe vepra të rënda kundër sigurisë publike. Të dyshuarit e tjerë janë persona të panjohur (NN). Autoritetet e Kosovës e cilësojnë sulmin në Banjskë si akt terrorist dhe akuzojnë Serbinë se qëndron

pas tij. Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë se ekzistojnë informacione të inteligjencës se të njëjtat grupe vazhdojnë të stërviten në territorin e Serbisë dhe rreth kufirit mes Kosovës dhe Serbisë. Nga ana tjetër, Serbia ka mohuar

çdo përfshirje në sulmin në Banjskë, ndërsa presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, ka theksuar se për Beogradin ky sulm nuk është terrorist, por se po hetohet. Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar ashpër sulmin në Banjskë dhe ka kërkuar që përgjegjësit të dalin para drejtësisë. (Rel)

# Kongresi i partisë së mos - punës, Vetëvendosje!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

**Modestia, si vlerë e shtuar e mashtrimit:** Partia e Punës e Shqipërisë, me diktatorin Enver Hoxha, Pallatin e Kongreseve e përdorte për mbajtjen e kongreseve dhe aktiviteteve tjera politike ku, më shumë merreshin vendime gjyqësore se politike. Vendimet ishin kryesisht me varje apo plumb pas koke për kundërshtarët politik që konsideroheshin dhe trajtoheshin si armiq të "popullit" dhe të shtetit (lexo të regjimit). Pallati i Kongreseve ka qenë varri i patriotëve më të mëdhenj shqiptarë, ku nuk janë vrarë aty por ku është vendosur për fatin e tyre. Sot në Pallatin e Kongreseve mbahet Panairi i Librit sikur edhe ngjarje tjera kulturore. Lëvizja Vetëvendosje e mbajti Kongresin (Këshillin e Përgjithshëm) jo në Pallatin e Kongreseve por në hotelin më luksoz në Kosovë, me të gjitha komoditetet dhe lukset që i ofron. Është mizorisht brutale për një parti që për ideal e kishte modestinë dhe "kazanin e përbashkët", si kusht për barazi dhe distancim nga keqbërësit e shtetit që kjo parti i quan regjim i vjetër në kohën kur është shndërruar në regjim të ri, regjim modern ku demokracia e vjetër zëvendësohet me autokraci të re të përfundojë në kushte të 1001 netëve. Kjo mbledhje e Këshillit të Përgjithshëm u identifikua vetëm me një person dhe fenomen, me Albin Kurtin, si alfa dhe omega dhe me sjelljet e tij prej autokrati, jo vetëm si fenomen por edhe si veprim që mendësi. Fryma mobilizuese e këtij Kongresi ishte urrejtja ndaj kundërshtarëve politikë të cilët i konsiderojnë si armiq. Urrëjtja ndaj mediave, ndaj institucioneve të drejtësisë dhe atyre që nuk pajtohen me ta. Krejt kjo bëhej në përpjekje për të mbuluar dështimet e pakundërshtueshme dhe të pamohueshme në të gjitha segmentet ekonomike, politike, arsimore, të drejtësisë,

zhvillimore etj. Defilimi i ministrave gjasonte në Teatrin e Marionetave - Kukullave ku penjtë tërhiqeshin nga antikombëtarja Mihali dhe Albin Baba me 40 mega hajdutë. Të pispillosur, parfumosur, të kollarisur dhe të katandisur në injorancën e tyre, ministrat e Haremit politik të Kurtit bënë garën se kush po gënjen më shumë, kush po shpifë më shumë dhe kush po ofron më shumë urrejtje për regjimin e vjetër, si kusht i domosdoshëm për mbijetesë politike dhe të pëlqehen nga Neroni i tyre që rrjedhshëm flet shqip. Nëse krahasoni përbërjen aktuale të piramidës së LV-së, krahasuar me më parë, sigurisht se 80 - 90 për qind janë aty për interesa personale, nuk kanë asgjë të përbashkët me çështjen kombëtare, janë të proveniencës jugosllave apo vëllazërim - bashkimit dhe brutalisht kanë keqpërdorur flamurin kombëtar. Janë kundër Shqipërisë dhe bashkimit kombëtar. Janë edhe kundër Kosovës. Janë kundër UÇK-së dhe udhëheqësve të luftës që i dërguan në Hagë. Janë kundër Bacë Adem Demaçit por që manipulojnë me emrin e tij kurdo që kanë nevojë. Sikur që manipulojnë me një pjesë të familjes Jashari. Janë të përbashkuar rreth pushtetit dhe posteve, rreth 273 milionëve të tenderëve njëburimor, rreth nepotizmit të jashtëzakonshëm dhe fanatizmit të mbrojtjes së anëtarëve apo balenave të korrupsionit masiv. Punësimin e anëtarëve partiakë e kanë shndërruar në standard moral dhe profesional që dhunon institucionin e konkursit. Albin Kurti nuk ka pasur nevojë që për bashkëpunëtorë të ketë njerëz të ndershmë, profesionalisht kompetent, me integritet të shëndoshë njerëzor dhe kombëtar shkaku se këta nuk do ia mbanin zhagun duke u shndërruar në llaskuçë të interesit prandaj është përcaktuar për këta që i ka me të cilët sundon si me sklevër të padenjë edhe për një liri minimale. Prandaj edhe i mbron me aq pasion. Që nga përfundimi i luftës kurrë nuk ka ndodhur që një KM të mbrojtë me aq vendosmëri rrogëtarë, siç e bënë Albin Kurti. Shkruhet se këta të këqij po e marrin në qafë Albinin, duke vjedhur dhe keqpërdorur

mbi tokë dhe nën tokë, në qiell, në parajsë e në ferr. Realisht, në LV asgjë nuk bëhet pa dijen dhe lejen e Kurtit, ai është kryenoteri dhe Gjykata Kushtetuese për LV-në, mendermethënë GUXO dhe ALTERNATIVEN.

**Çka u mësua nga Kongresi i partisë së mos - punës, LV:** U mësua se Albin Kurti është vet LV-ja, pa të do të ishte mbetje mortore politike. Prandaj të gjithë i luten, falen, përkulen dhe përqurren para kultit të Zeus Kurtit sepse pa te, jeta mbaron. Po vetëm Kurti do ta bënte një analfabete, ministre të Arsimit. Një injorante joprofessionale do ta bënte ministre për vjedhje të rezervave shtetërore. Një ministre që e ka humbur rrugën në oborrin e saj e bënë ministre që i shkelë rrugët ajrore, tokësore dhe ujore të botës, pa e pasur të qartë se ku shkon dhe pse shkon. Një kësulëkuqe, të cilën nuk do ta haje as ujku më i uritur në botë e ngarkon me zbatim të sheriatit partiak. Një cub të pakultuar e ngarkon me kulturë. Një dhunues të Policisë e bënë kryesorin e policisë.

Albini në Kongresin e partisë së mos - Punës gënjeshtrohet dhe mashtrimet për zhvillim ekonomik dhe punësim i shiti si të dhëna më të besueshme të Entit Statistikor. Militantët i besuan verbërisht, mos keni pritur të kundërtën. Albin Kurti po e lufton Rusinë, si sozi e Zelenskit dhe Vojsa Osmanit. Kurse, nuk guxon ta gjykojë gjenocidin e Izraelit në Gaza. Nuk guxon të përmend 42.000 palestinezë të vrarë dhe mbi 100.000 të plagosur sikur ekocidin dhe urbanocidin në masë midis 80 - 90 për qind. Po në Gazë të Palestinës. KM mundohet të baraspeshojë krimin dhe kriminelët me viktimat dhe pafajësinë. Deklaron se nuk duhet të bashkëpunohet me ata që janë non grata në listën amerikane, Mimoza Kusarin, si bashkëpunëtorë të vullnetshme të non grata Radojiçiqit, e mbanë në krye të tryezës të qeverisë Kurti 2. Me Radojiçiqin dhe qyqekokerkën e Gadafit, më lehtë e lufton UÇK-në dhe veteranët e luftës. Si vlerë e shtuar e këtij kombinimi është edhe paramilitari Hekuran Murati apo Jack Smith i veteranëve të

luftës. Një jonjeri, me patologji të theksuar kundër UÇK-së dhe veteranëve të luftës. Hekuran Murati është më i rrezikshëm se Donika Shvarc në luftë kundër UÇK-së, veteranëve të luftës, të burgosurve politikë dhe Bacë Adem Demaçit, Donika Shvarc ka vetëm urrejtje të palimituar kurse Teneqe Murati përveç urrejtjes, gjithashtu pa kufij, e ka edhe kuletën e shtetit!

KM Kurti, duke përmendur mendermethënë GUXO dhe Alternativen, e luajti zbutësin ndaj Vojsa Osmanit, jo se ka ndonjë respekt a konsideratë për presidentin e shkarkuar nga vet Kurti por se mundohet ta pengojë kthimin e votave që Vojsa Osmani pabesisht ia ka marrë LDK-në, për dobi të Kurtit. Nëse e pengon kthimin e votave të LDK-së përmes joshjes edhe për një mandat të presidentes, pas zgjedhjeve Albin Kurti do ta lëshojë Vojsa Osmanin te bifurkacioni i Nerodimes duke e zhdukur në njërin prej detave. Nuk besoj se Kurti dhe Vojsa, edhe nëse e lidhin Paqen Romake do të mund të ndalojnë kthimin e votave të LDK-së, të LDK-ja. Prandaj LDK-ja edhe do të rritet. Prandaj edhe PDK-ja do të rritet. Prandaj edhe AAK-NISMA do ta kalojnë pragun pupalec. Prandaj edhe Lista për Familje do të bëhet parti parlamentare. Prandaj LV-ja duhet ta harrojë 21 shkurtin dhe 50 përqindëshin. Për aq sa rriten këto parti për aq do të shembet LV-ja. Prandaj kanë nevojë për përkrahje nga mbetjet jugosllave, serbe, ish-udbashët dhe antikombëtarët. Prandaj kanë nevojë që të besojnë në sondazhet me 70 për qind të fitores së LV-së që e thotë kumbara i Millorad Spasiqit, deputet i Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës, pas zgjedhjeve të ardhshme do të ketë 5 parti shqiptare, do të shpërndahen votat. Askush nuk do ta fitojë shumicën absolute.

**Parimësia e Kurtit:** Këtë armë, tashmë me barut të lagur e ka përdorur Kurti më herët. Sidomos me rastin e veriut të Kosovës. Lëshimet që i ka bërë Albin Kurti deri më tani janë të papërfillshme dhe beninjë krahasuar me lëshimet që do të detyrohet t'i bëjë në veri të Kosovës. Këtë e ka shumë të qartë KM Kurti prandaj po e përdor dramatizimin, si mjet

qetësues dhe ikje nga realiteti. Po e përdorë kërcënimin me luftë si gogol për qytetarët e Kosovës. Kush do ta bëjë luftën, Dimal Basha, narkomanët e Prizrenit, Mef Bajçina, Seneka i Kuvendit, apo kërkueset e puthjeve?!?! Luftën e bëjnë ata që e kanë bërë çdoherë kur duhej, fëmijët e tyre të cilët Albin Kurti, me shpurën jugosllave që është i rrethuar, i konsideron armiq. Nuk ka luftë në Kosovë pa e vendosur Putini. As Albini e as Vuçiqi.

**Bota po vlon, ne nuk e shfrytëzuan Banjskën:** Vëmendja e botës po përqendrohet në Ukrainë, Gaza, Iran, Tajvan dhe Kinë ku ka miliona viktime dhe ku po rrezikohet rendi botëror kurse ne po e bombardojmë me Manastirin e Banjskës. Me Radojiçiqin që ishte bashkëbisedues me Mata Harin, si vallëzuese vetëm e Gadafit dhe i cili mori tenderë nga Kosova edhe pasi u nxi në Listën e zezë amerikane, me kërkesën për ekstradim në Kosovë dhe përralla të tjera. Askush nga qendrat vendosëse ndërkombëtare nuk ka kërkuar ekstradimin e mikut të Limozës në Kosovë por nxjerrjen para organeve të drejtësisë në Serbi. Dhe këtu merr fund kjo punë.

**Gjithandej shqiptarë të përçarë:** Në Kosovë LV ka krijuar një debat toksik, jo një debat konstruktiv midis kundërshtarëve politikë. Jonormale, përfundimisht. Në Maqedoni të Veriut, fuqia politike e fituar me Ali Ahmetin, po shkrihet si akullnaja në Antartik, ka rrezik që edhe gjuha shqipe të dezyrtarizohet, të barazohet me gjuhën e vllahëve, torbeshëve dhe aborixhinëve ndonëse shqiptarët përbëjnë së paku 35 për qind të popullatës së këtij shteti. VLEN, bashkë me Travarin dhe Bekim Koqjen kanë merita të pakundërshtueshme për këtë, si rrogëtarë të Albinit. Në Mal të Zi shqiptarët po mrizojnë nën qeverinë proserbe. Në Luginë të Preshevës, si në Maqedoni të Veriut. Kurse, në Piemontin e Shqiptarisë, në Shqipëri, në emër të mosbindjes civile e që në fakt është terrorizim partiak dhe politik, po i vihet flaka vendit, sikur në kohën e Zani Çaushtit. Të paudhët!!!



# Memorandum për fuqizimin e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë në sektorin privat

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 TETOR - Oda e Infermierëve Mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë të Kosovës (OIK) dhe Asociacioni i Spitaleve Private të Kosovës (ASPKS) kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi.

Memorandumi është nënshkruar nga kryetarja e OIK-ut, Nexhmije Gori dhe kryetari i ASPKS-it, Armend Agani.

Ky memorandum ka për qëllim krijimin e një bashkëpunimi në mes të OIK-ut dhe ASPKS-it për të zhvilluar një mekanizëm koordinues, në shkëmbim të informatave rreth të punësuarve,

anëtarë të OIK-ut, dhe aktiviteteve profesionale që synojnë zhvillimin e shërbimeve shëndetësore në Kosovë.

Po ashtu, memorandum i ka për qëllim përkrahjen e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë për rritjen e cilësisë së punës së tyre në institucionet private shëndetësore.

Qëllim i memorandumit mbetet bashkëpunimi në përmirësimin e politikave dhe procedurave për ngritjen e kapaciteteve profesionale të infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë, dhe përfaqësimi dinjitoz i interesave të tyre brenda institucioneve private shëndetësore. Oda si dhe Asociacioni i Spitaleve



Private kanë marrë për obligim të angazhohen për mbrojtjen dhe fuqizimin e pozicionit të infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë brenda sektorit privat shëndetësor, duke promovuar standardet më të larta etike, mbështetje përmes edukimit të vazhdueshëm profesional dhe praktikës profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

ASPKS-ja do të sigurojë mbështetje institucionale për implementimin e reformave dhe praktikave më të mira që lidhen me shërbimet e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë në institucionet private shëndetësore.

## Kryetari i KPM-së zgjedhet zëvendëspresident i MNRA-së



Prishtina, 9 tetor - Jeton Mehmeti, kryetar i Komisionit të Pavarur të Medie, është zgjedhur zëvendëspresident i Rrjetit të Rregullatoreve të Shteteve të Mesdheut (MNRA), në Asamblesë Plenare të 23-të të mbajtur në Jerevan të Armenisë. Ky rrjet, që përbëhet nga 27 anëtarë, ka për qëllim shkëmbim e njohurive dhe përvojave mes shteteve anëtare për çështje që kanë të bëjnë me rregullimin e medie. Sipas rregullave të këtij rrjeti, Kosova do të jetë nikoqire e Asamblesë Plenare në vitin 2025, me ç'rast edhe merr

me automatizëm Presidencën e MNRA-së.

Në fjalën e tij Mehmeti i falënderoi shtetet anëtare për besimin e dhënë. "Viti 2025 shënon 20-vjetorin e themelimit të Komisionit të Pavarur të Medie. Do të jetë nder për ne që, krahas organizimit të Asamblesë Plenare, t'ju tregojmë edhe zhvillimin e KPM-së nga një entitet i administruar nga UNMIK me emrin Komisionari i Përkohshëm i Medie në një rregullator të pavarur të medie", tha ai.

Temë kryesore në punimet e

asamblesë në Yerevan janë parimet e UNESCO-s mbi administrimin e platformave digjitale si dhe përdorimi i inteligjencës artificiale në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Përveç kryetarit Mehmeti, nga KPM pjesëmarrës janë edhe Herolinda Zagragja dhe Bashkim Reçica. MNRA është themeluar në vitin 1997 me iniciativë të Francës dhe Spanjës. Në mesin e shteteve të tjera anëtare janë Greqia, Qipro, Izraeli, Malta, Maroku, Turqia, Shqipëria dhe shtetet e tjera të rajonit.

## Kosovës i shtohet edhe një parti e re, në Drenas themelohet Bashkimi Demokratik



Drenas, 9 tetor - Bashkimi Demokratik (BD) do të jetë parti më re, e themeluar tash së fundmi në Drenas. Lajmin e ka dhënë në "Facebook", Zeqir Bekolli, i cili ka shpërndarë edhe komunikatën e kësaj partie.

Në komunikatën për medie thuhet se kjo parti tashmë ka dorëzuar në KQZ kërkesën për regjistrim.

Bashkimi Demokratik është me orientim pro ShBA-së, vlerave euroatlantike, BE-së dhe NATO-s. "Bazuar në rrethanat politike në

vend dhe në komunën e Drenasit, një grup intelektualësh të këtij mjedisi, të përkrahur edhe nga qytetarë të shumtë, ka kohë që janë marrë vesh për formimin e një partie politike. Pas një pune, pothuaj njëvjeçare, tashmë janë gati aktet normative, simbolet, organet dhe është caktuar selia e partisë. Ndërsa në KQZ është dorëzuar kërkesa për regjistrim. Këto ditë pritjet edhe prezantimi publik i partisë. Partia politike e emërtuar 'Bashkimi Demokratik'

është me orientim pro ShBA-së, vlerave euroatlantike, BE-së dhe NATO-s. Si parti e qendrës, Bashkimi Demokratik është një formacion politik i pozicionuar në mënyrë të balancuar në spektrin politik, duke kombinuar elemente të politikës së majtë dhe të djathtë, që kërkon të ofrojë zgjidhje të moderuara dhe përpqet t'i përmbushë interesat e një grupi të gjerë qytetarësh, pa u angazhuar plotësisht për ideologji të ekstremit të majtë ose të djathtë.

Objektiv i partisë Bashkimi Demokratik, në këtë fazë, do të jetë gara komunale, që mbahet vitin e ardhshëm në komunën e Drenasit, dhe krijimi i një konkurrence demokratike për një klimë sa më të përshtatshme në komunë, për një zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi e infrastrukturë cilësore, që do t'i krijojë kushte qytetarit për një jetë shumë më të mirë, se deri më tash", theksohet në komunikatën e BD-së.

## Anëtari i Kryesisë së LDK-së: Kosova pa asnjë njohje në katër vitet e fundit

Prishtinë, 9 tetor - Anëtari i Kryesisë së LDK-së, Muhamet Hamiti, ka thënë se Kosova është izoluar ndërkombëtarisht. "Pa asnjë njohje në katër vitet e fundit. Më larg integriteteve euroatlantike se kurrë. Dështimi për anëtarësim në Këshillin e Evropës e dëshmon këtë. Kosovë e sanksionuar ndërkombëtarisht. Qindra milionë euro të humbura deri

tani. Humbjet vazhdojnë. I vuan populli i Kosovës, jo Qeveria e saj e papërgjegjshme", ka shkruar Hamiti në "Facebook".

Ai ka shtuar se Kosova ka qeverinë më të korruptuar në historinë e vet. "Departamenti Amerikan i Shtetit e ka kualifikuar si 'korruption të rëndë qeveritar' (serious government corruption).

Aferat korruptive të përditshme kanë dalë para syve të opinionit publik tashmë, mbasi ishin mbajtur fshehtë për kohë të gjatë. Kryetar i kësaj Qeverie të korruptionit dhe propagandës është Albin Kurti, që e kërkon votën sërish. Për çka? Për ta mbajtur Kosovën të izoluar, nën sanksione, nën korruption masiv?", ka shkruar Hamiti.






## AKB-ja kundërshton ligjin e ri për tatimin në pronë

Prishtinë, 9 tetor - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka bërë një reagim mbi ligjin e ri për tatimin në pronë. Në reagim thuhet se në Kosovë tatimi në pronën komerciale dhe private nga viti 2025 do të jetë më i larti në Ballkanin Perëndimor. "Ligji i ri për tatimin në pronë, i miratuar vitin e kaluar do të ketë efekt

në ngritjen të lartë të tatimit në pronë dhe Prona Komerciale nga viti i ardhshëm. AKB-ja e kundërshton këtë ligj sepse do të ketë ngritje të faturave të tatimit në pronë komerciale 200-300%, kjo është një barrë e lartë për bizneset dhe investitorët më ndikim negative të drejtpërdrejt në

zhvillimin ekonomik të Kosovës. Aleanca Kosovare e Bizneseve dhe kryetari i saj Agim Shahini i kërkojnë Qeverisë së Kosovës amendamentimin e këtij ligji në mënyrë që projektligji i ri të diskutohet me biznese dhe me qytetarët të Republikës së Kosovës", është thënë në reagimin e AKB-së.



## KMDLNj: Rritje klienteliste dhe diskriminuuese e pensioneve

PRISHTINË, 9 TETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) e ka quajtur diskriminuuese dhe klienteliste rritjen e pensioneve. "Ka qenë e sigurt se qeveria do t'i rrisë pensionet dhe skemat sociale sikur që ka mundësi reale të rriten edhe pagat në arsim. Realisht këto grupe të targetuara përfituese kanë shumë votues andaj edhe ishte i pritshëm vendimi i qeverisë. KMDLNj edhe më parë ka kërkuar të rriten pensionet, por jo në këtë mënyrë dhe këtë përqindje. KMDLNj kishte kërkuar të bëhej indeksimi në vitin 2022 kur inflacioni ishte 22 për qind dhe pastaj të bëhet rritja. Me rritjen prej 20-përqindësh askush nuk



përfiton përveç qeverisë. Madje me këtë rritje pensionistët dhe përfituesit e tjerë nuk marrin më shumë se 90 për qind nga

pensionet paraprake. Qeveria është dashur të konsultohet me përfaqësuesit e pensionistëve për të arritur një zgjidhje të pranuar për të

gjithë. Për më keq, qeveria ka injoruar Shoqatën e Pensionistëve të Kosovës duke mos e pranuar në takime dhe duke shpërfillur, nga pozita e arrogancës së pushtetit, dialogun social. Në këtë mënyrë vetëm e ka betonuar agoninë e pensionistëve në luftë për mbijetesë nën çdo dinjitet përmes rritjes klienteliste të pensioneve që do të përket në përqindje të votave për zgjedhjet e ardhshme. Në anën tjetër me mospërfshirje të kategorive të luftës në këtë 'ritje' është diskriminim flagrant dhe shkelje e barazisë para ligjit", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, pensionistët dhe përfituesit e tjerë nuk duhet të pajtohen me këtë rritje klienteliste të

pensionit dhe duhet të kundërshtojnë, qoftë përmes rrugëve ligjore apo edhe me votën e tyre. "Ka qenë detyrim ligjor i qeverisë që të bëjë indeksimin e pensioneve në përputhje me rritjen e shkallës së inflacionit e jo të konsiderohet se është vullnet i mirë i qeverisë dhe përkujdesje për pensionistët. Le të merren praktikatat e vendeve të rajonit dhe të krahasohen me vendimin e qeverisë për pensione. Qeveria e Kosovës me këtë klientelizëm diskriminues në mënyrë brutale po i shkelë të drejtat e njeriut të pensionistëve dhe grupeve të cenueshme për një jetë më të dinjitetshme dhe qëndrueshmëri sociale", theksohet me tutje në reagimin e KMDLNj-së.

## Një delegacion i BQK-së viziton Maltën, guvernatorët shkëmbejnë përvojat rreth qëndrueshmërisë së sistemit financiar

PRISHTINË, 9 TETOR - Një delegacion i lartë i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), i kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili dhe i përbërë nga anëtarët joekzekutivë të Bordit, Bashkim Nurboja, Nora Latifi dhe Arta Hoxha, mori pjesë në një vizitë zyrtare në Bankën Qendrore të Maltës.

Në takim hyrës, delegacioni i BQK-së u prit nga u. d. guvernatori i Bankës Qendrore të Maltës, Alexander Demarco, i cili ishte i shoqëruar edhe nga zëvendësguvernatori Bonello, kryeekonomisti Grech, shefi i Operacioneve Romano dhe anëtari joekzekutiv i Bordit, profesor Bezzina.

Gjatë takimit guvernatorët e të dy bankave qendrore shkëmbyen informacione rreth zhvillimeve kryesore në sektorin financiar dhe në ekonomi.

Guvernatori Ismaili e informoi guvernatorin Demarco për zhvillimet në kornizën ligjore dhe atë rregullative, projektet strategjike të BQK-së, si dhe për



qëndrueshmërinë e sistemit financiar të Kosovës.

Të dy delegacionet diskutuan kryesisht mbi qeverisjen dhe auditimin, menaxhimin e rrezikut, sistemin e pagesave dhe përgatitjet e duhura për

anëtarësim në SEPA, menaxhimin e rezervave ndërkombëtare, parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe kërkimet shkencore, ndër të tjera. Në përfundim të vizitës palët

rikonfirmuan përkushtimin e tyre për bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve, ku BQK-ja ka për synim zgjerimin e rrjetit të bankave qendrore partnere si pjesëmarrëse në Eurosistem, menaxhimin e rezervave

ndërkombëtare dhe në fusha të tjera të bashkëpunimit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës shpreh mirënjohjen e thellë për Bankën Qendrore të Maltës për mikpritjen dhe organizimin.

## Qeveria miraton Projektligjin për Shërbimet e Pagesave

PRISHTINË, 9 TETOR - Në mbledhjen e qeverisë të mërkurës është miratuar Projektligji për Shërbimet e Pagesave. Ministri i Financave, Hekuran

Murati, tha se me miratimin e këtij projektligji do të hapet rruga e integritimit të sistemit tonë financiar me zonën SEPA (Single Euro

Payments Area). "Me integrim në SEPA, bizneset dhe qytetarët tanë parashihen të kursejnë rreth 50 milionë euro në vit nga tarifat e transfereve. Çdo

ditë me punë drejt lehtësimit e përmirësimit të jetës së qytetarëve", thotë ministri Murati.

Tutje ai ka pohuar se qeveria është për të gjithë.





**Prof. dr. EQREM ZENELAJ  
Paris Memaj nga Dardania**

**Urim nga Puka me rastin  
e akordimit të titullit:  
“Qytetar Nderi” i  
Bashkisë së Pukës**



Fran VUKAJ, regjisor e poet  
“Qytetar Nderi”

Profesor Eqrem Zeneli  
E gëzofsh këtë titull nderi  
Në ballë të ndrinë dituria  
Paris Memaj nga Dardania.

Kaq madhështor e kaq fisnik  
Të njeh Evropa si akademik  
Të njeh Prishtina dhe Austria  
Të vlerëson Franca e Gjermania.

Sa shumë tituj ke nëpër botë  
Por nuk ka si vendi yt  
Veç ky titull që more sot  
Ta ka njomur syrin me lot.

Në panele diplomatike  
Sa shumë larg të shkojë jehona  
Mbrojte çështjen pellazge  
U tregove rrënjët tona.

“Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”  
Zemra e shpirti i Atdheut  
Paris Memaj nga Dardania  
Është krenar me TY Shqipëria.

*Pukë, më 17.9.2024*




Eqremi dhe nipi i tij, Sedat Zenelaj



Kryetari i Këshillit Bashkiak, Gjon Gjoka, dhe deputeti  
propozues në Parlamentin e Shqipërisë për titullin 'Qytetar  
Nderi', Lodovik Hasani



Medalja 'Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut'



Medalja e Pukës



Medalja e Fushë Arrëzit

**EQREM ZENELAJ**



Gjovalin DUSHAJ

Për këto vlera të shqiptarisë  
Flasin shkencat e Austrisë  
Flasin titujt e profesorit  
Flet vendlindja e Graikovcit.

Profesor nga Dardania  
E thotë Franca e Gjermania  
Kontributi që ka dhënë  
E njeh bota anembanë.


Profesor në shërbim të atdheut  
Është “Kalorës i Skënderbeut”  
Si në Fushë Arrëz e në Pukë njëzëri  
Krenari “Qytetar Nderi”.

Eqrem Zenelaj sot  
Ka medalje e tituj plot  
Që ia dhanë në disa shtete  
Për merita në fusha jete.

Nderoi e nderoi flamurin  
Botoi librin me Dod Lulin  
Dhe i thanë gjithë botës mbarë  
Papa Klementi është shqiptar.

Për këtë burrë - këtë profesor  
E ka nder çdo auditor  
Për leksionet me shumë vlera  
Puka i thotë sot - t’u rritë ndera!





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kosova vazhdon përgatitjet për ndeshjet e tetorit, Emerllahu kërkon 6 pikë

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka zhvilluar të mërkurën stërvitjen e radhës në kuadër të përgatitjeve për ndeshjen kundër Lituanisë, e cila zhvillohet të shtunën në kuadër të Ligës së Kombeve.

Përzgjedhësi i "dardanëve", Franco Foda, edhe në këtë seancë është përqendruar në aspektet taktike, të cilat synon t'i zbatojë në këtë ndeshje. Portieri Aro Muriq sërish nuk është përfshirë në stërvitje për shkak të një lëndimi të lehtë, kurse Leart Paçarada ka marrë pjesë vetëm në pjesën e parë të stërvitjes dhe më pas ka vazhduar

me ushtrime më të lehta nën kujdesin e trajnerit të fitnesit. Pas stërvitjes ka folur mesfushori Lindon Emërllahu. Ky i fundit ka thënë se stërvitjet po shkojnë mirë dhe se me disiplinë dhe angazhim në fushë synim është marrja e gjashtë pikëve në dy ndeshjet e këtij muaji kundër Lituanisë në Kaunas dhe ndaj Qipros në Prishtinë. "Mendoj se kanë shkuar mirë përgatitjet këto tri ditë. Siç po e shihni edhe vetë, angazhimi është maksimal nga të gjithë futbollistët. Kemi një grup të mirë. Disa janë më përvojë. Është bërë një kombinim i mirë. Shpresoj shumë që në këto dy ndeshje t'i marrim gjashtë pikë. Vëmendja fillimisht është në ndeshjen e parë të shtunën ndaj Lituanisë", ka thënë Emërllahu.

I ftuar sërish në përfaqësues, Muharrem Jashari ka shprehur optimizëm për rezultate pozitive në dy ndeshjet e radhës në Ligën e Kombeve. "Është një emocion shumë i veçantë dhe ndihem i lumtur që jam pjesë e kombëtares përsëri. Shpresoj të debutoj dhe këto dy ndeshje t'i fitojmë. Grupi është shumë i bashkuar, shumë i motivuar, me një energji shumë të mirë. Duke i parë stërvitjet, mendoj që këto dy ndeshje do të dalim me rezultate pozitive", ka thënë Jashari.

Kosova stërvitjen e ardhshme do ta zhvillojë sot (e enjte) në Kampin Nacional në Hajvali, në orën 11:00, derisa pasdite ekipi udhëton për në Kaunas.



## Miratohet Projektligji kundër dukurive negative në sport

PRISHTINË, 9 TETOR - Në mbledhjen e radhës të Qeverisë së Kosovës është miratuar Projektligji kundër dukurive negative në sport.

Zëvendësministrja e Sportit, Daulina Osmani, theksoi se ky ligj është i bazuar në standardet e Këshillit të Evropës dhe definojnë dhunën në sport dhe obligon strukturat sportive t'i zbatojnë rregullat për parandalimin, raportimin efikas dhe sanksionimin e dhunës. "Pas konsultimit me komunitetin sportiv, kemi përgatitur Projektligjin kundër dukurive negative në sport i cili bazohet në standardet konkrete të Këshillit të Evropës dhe të federatave ndërkombëtare sportive. Ky projektligj definojnë dhunën në sport dhe obligon strukturat sportive t'i zbatojnë rregullat për parandalimin, raportimin efikas dhe sanksionimin e



dhunës. Parasheh standardet e rendit dhe sigurisë gjatë organizimit të ngjarjeve sportive si dhe simulon dialogun e grupeve të tifozëve me organizatat sportive për mbarëvajtje sa më të mirë të ngjarjeve sportive.

Projektligji vendos masa dhe veprime kundër kurdisjeve dhe basteve në sport", ka thënë Osmani. Miratimi i projektligjit u bë pa asnjë votë kundër në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës.

### SHKURT

#### Zyrtare: Bledar Devolli, trajner i ri i Lirisë

FC Liria e ka zyrtarizuar Bledar Devollin trajner të skuadrës. Strategu nga Shqipëria në krye të skuadrës nga Prizreni e zëvendëson Granit Begollin, i cili është larguar ditë më parë nga ky klub. "FC Liria ka kënaqësinë të njoftojë zyrtarizimin e trajnerit të ri, Bledar Devolli. Me një karrierë të pasur dhe përvojë të konsiderueshme në futbollin shqiptar, Devolli sjell me vete vizion dhe profesionalizëm. Klubi beson se nën drejtimin e tij, FC Liria do të vazhdojë rrugën drejt suksesit dhe do të përmbushë objektivat e saj", thuhet në njoftimin e klubit prizrenas.

#### Mervan Bejtullahu do ta ndajë drejtësinë në sfidën Hungari U21 - Malta U21

UEFA delegon Mervan Bejtullahun si gjyqtar kryesor që ta ndajë drejtësinë në ndeshjen e kualifikimeve për Evropianin U21, Hungaria - Malta. Në ndeshjen e cila do të zhvillohet në stadiumin "Hidegkuti Nandor Stadion" në Budapest, gjyqtarin Bejtullahun do ta asistojnë Fatmir Sekiraqa dhe Arbnor Bullatovci, ndërsa gjyqtari i katërt do të jetë Mentor Ajeti. Kjo ndeshje do të zhvillohet të enjten më 10 tetor me fillim në orën 20:00.

#### Ramadani, lider i mesfushës në Itali

Ylber Ramadani është motori i mesfushës së Lecces edhe në sezonin e dytë në Serinë A. Kur janë luajtur shtatë ndeshjet e para, mesfushori nga Shtimja konfirmohet sërish lider jo vetëm për ekipin e tij, por edhe në rang mesfushorësh në Serinë A. Të dhënat e publikuara nga Seria A tregojnë një statistikë tepër domethënëse, që e nxjerr Ramadanin si rikuperuesin më të mirë të kampionatit deri në këtë pikë të sezonit. Me 60 topa të rikuperuar, Ramadani kryeson renditjen, duke lënë pas të gjithë yjet e mesfushës në Serinë A. Ylli kuqezi lë pas dyshen e mesfushës së Napolit, Lobotka dhe Anguissa, me 49 dhe 45 topa të rikuperuar respektivisht.

#### Drenica pa asnjë humbje, por ndërpret bashkëpunimin me trajnerët Visoka e Gjeraj

Skuadra e Drenicës nga Skenderaj ka befasuar të gjithë, pasi ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Megzon Visoka dhe asistentin Robert Gjeraj edhe përkundër asaj se ende nuk ka shijuar humbje në Ligën e Parë. "Klubi Futbollistik 'Drenica' njofton opinionin futbolldashës, dashamirët, tifozët dhe qytetarët se është ndërprerë bashkëpunimi me marrëveshje dhe mirëkuptim të dyanshëm me kryetrajnerin Megzon Visoka dhe asistentin Robert Gjeraj. Klubi falënderon Visokën dhe Gjerajn për bashkëpunimin e deritanishëm dhe i falënderon për punën dhe angazhimin gjatë kësaj periudhe, duke u uruar shëndet dhe suksese në karrierë", thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi.



## Kumbulla: Vështirë ndaj Çekisë, futemi në fushë për dy fitore

TIRANË, 9 TETOR - Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Marash Kumbulla, ka thënë se dy kundërshtarët e radhës janë shumë të vështirë por, si gjithmonë, kuqezinjtë do të futen në fushë për të fituar.

“Ne do të futemi në fushë si gjithmonë për të fituar të dy ndeshjet. Tani mendojmë vetëm për Çekinë. Është një ekip shumë fizik dhe i fortë në duela. Tani mendojmë vetëm për ata dhe të shohim

më pas për Gjeorgjinë”, ka thënë Kumbulla, i cili nuk ka qenë në dy ndeshjet me Çekinë në kualifikueset e Evropianit. “Po, sigurisht. Të dy ndeshjet i kam parë nga shtëpia. Siç thashë edhe më

parë, me Çekinë do të jetë një ndeshje shumë e vështirë. Ne jemi shumë të motivuar. Edhe ekipi kundërshtar gjithashtu. Presim një ndeshje shumë të vështirë”, ka shtuar Kumbulla.



## Uta Ibrahim ngjitet në majën Shisha Pangma, vetëm edhe një majë drejt rekordit ballkanik

Prishtinë, 9 tetor - Vitin e kaluar e gjithë bota u tund nga vdekjet tragjike në këtë majë, ku katër vajza brenda ekipit me të cilin alpinistja jonë ishte nisur, ndërruan jetë nga ortekët e avalanshet. Tre muaj më parë Uta u nis përsëri drejt Kinës me synimin për t'u ngjitur në majën Shisha Pangma. Megjithatë, ekspertët konstatuan se rreziqet ishin të shumta, duke e bërë të pamundur nisjen e ekspeditës. Pa humbur kohë, Uta vendosi të vazhdojë përpara dhe sfidoi majën Gasherbrum 2, duke u ngjitur me sukses në këtë majë të lartë. Ndërsa me datën 9 tetor 2024, Uta Ibrahim arriti një tjetër moment historik në karrierën e saj të alpinizmit, duke ngjitur me sukses majën Shisha Pangma, një ndër majat më të vështira dhe të rrezikshme të Himalajeve. Pas dy tentativave të mëparshme, Uta me këmbëngulje dhe përkushtim triumfoi, duke shtuar një tjetër arritje të jashtëzakonshme në listën e saj të sukseseve. Kjo ngjitje u bë në kuadër të një ekspedite ndërkombëtare të organizuar nga Seven Summit Treks (SST), ku morën pjesë 29 alpinistë dhe Sherpa nga vende të ndryshme të botës. Sipas raportimeve të SST, të gjithë pjesëtarët e ekipit arritën majën e Shisha Pangma me sukses në orën 6:00 të mëngjesit, me kohën lokale. Kjo arritje përbën një moment të



rëndësishëm për 12 nga alpinistët që përfunduan sfidën e ngjitjes së 14 majave më të larta të botës, duke u bashkuar në klubin ekskluziv të 8000-metërsheve. Një sfidë të cilën Uta pritet ta arrijë vitin tjetër duke u bërë e vetmja në Ballkan që ka arritur këtë sukses në alpinizëm. Me këtë sukses Uta Ibrahim i afrohet përfundimit të një misioni të jashtëzakonshëm, duke mbetur vetëm edhe një majë për ta përmbytur qëllimin e saj të ngjitjes së të gjitha 14 majave më të larta të Himalajeve. Duke u bërë një nga gratë e pakta në botë që arrin këtë, Uta forcon pozicionin e saj si një nga alpinistet më të shquara ndërkombëtarisht dhe një frymëzim për shumë të rinj e të reja që ndjekin rrugën e saj drejt lartësive. Maja Shisha Pangma,

me lartësinë e saj prej 8,027 metrash, është e njohur për kushtet sfiduese dhe rreziqet e mëdha që paraqet për alpinistët. Uta, përmes guximit dhe përkushtimit të saj të pandërprerë, dëshmoi edhe një herë se asgjë nuk është e pamundur kur ndjek një qëllim me përkushtim dhe vendosmëri. “Jemi jashtëzakonisht krenarë për arritjet e ekipit tonë dhe presim shumë ekspedita të tjera të suksesshme në të ardhmen”, deklaroi SST. “Seven Summit Treks është i nderuar të ketë një ekip kaq të jashtëzakonshëm”. Ndërkohë që e gjithë bota e alpinizmit ndjek me interes këtë rrugëtim, Uta mbetet një simbol i fuqisë dhe qëndrueshmërisë jo vetëm për gratë, por për të gjithë ata që guxojnë të ëndërojnë lart.

### SHKURT

#### Shqiponja fiton me një gol dallim në Vushtrri

Me rezultatin 37:36, Shqiponja e mposhti të martën mbërëma Vushtrrinë në ndeshjen e xhiros së katërt të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Kjo ndeshje u shty pas Shqiponja ia huazoi dy lojtare Ferizajt për ndeshje evropiane. Shqiponja tani i ka gjashtë pikë në vendin e tretë, sa i kanë edhe Istogu e Ferizaj në dy pozitat e para. Vushtrria është e shtata me dy pikë. Mysafiret nga Gjakova herët u shpëputën në rezultat, ndërsa pas 30 minutave lojë rezultati ishte 22:16 për Shqiponjën. Në pjesën e dytë Vushtrria u afrua në një gol, por pa ia dalë të barazojë. Në pesë minutat e fundit Shqiponja u shpëput 36:31 e 37:34. Në fund vendaset i shënuan tri gola për rezultatin final, 37:36, në të mirë të Shqiponjës. Ghabriell Rosa Silva udhëhoqi Shqiponjën me 10 gola. Nëntë i kishte Alma Nivokazi, kurse nga gjashtë i shënuan Aurora Lokaj e Larisa Ferizaj. Gentiana Basholli i shënoi nëntë gola për Vushtrrinë. Tetë i kishte Agnesa Hysa, shtatë Qëndresa Tërstena e gjashtë Burneta Rama. Ndeshja tjetër e shtyrë e xhiros së katërt në mes të Ferizajt dhe Besës zhvillohet javën tjetër.

#### Lëndohet Uzuni, Sylvinho thërret Tucin

Nuk ka aspak lajme të mira në Kombëtaren e Shqipërisë, teksa do të ketë sërish ndryshime në prag të ndeshjeve të Ligës së Kombeve ndaj Çekisë dhe Gjeorgjisë. FSHF-ja bën me dije se sulmuesi Myrto Uzuni ka pasur një problem muskolor në ndeshjen e fundit me klubin, por u paraqit në Kombëtare për t'iu nënshtruar analizave mjekësore. Dje futbollisti bëri një rezonancë magnetike që evidentoi një dëmtim në muskujt e pulpës së djathtë. Për këtë arsye, lojtari nuk mund të jetë i disponueshëm për ndeshjet e Kombëtares në tetor dhe do të kthehet në klubin e tij për ta vazhduar programin e rikuperimit. Trajneri Sylvinho ka vendosur të thërrasë në vendin e tij sulmuesin Indrit Tuci, i cili pritet të mbërrijë sot në Tiranë për t'iu bashkuar ekipit në përgatitjet për dy transfertat e rëndësishme.

#### Alissoni mungon gjashtë javë

Liverpooli ka marrë një goditje të madhe nga lëndimi i portierit të tyre kryesor Alisson Becker në fundjavën e kaluar. Portieri i “Reds”, Alisson Becker, ka pësuar një goditje të rëndë pasi do të mungojë për shkak të një dëmtimi deri në pushimin e ardhshëm ndërkombëtar. Ka qenë gazetari italian Fabrizio Romano që ka konfirmuar se “The Reds” do të jetë pa brazilianin deri në gjashtë javë. “Portieri i Liverpoolit, Alisson, do të mungojë rreth gjashtë javë, pasi rezultatet e testeve të reja konfirmuan një dëmtim të kërdhokullës, siç pritej. Alisson nuk do të kthehet deri pas pushimit të ardhshëm ndërkombëtar në mes të nëntorit. Goditje e madhe për ‘Reds’”, ka shkruar Romano. Arne Slot do t'i drejtohet edhe një herë zëvendësit të besuar të Alisson, Caoimhin Kelleher, për ta zëvendësuar brazilianin, diçka që ai e ka bërë herë pas here. Alisson do t'i humbasë shtatë ndeshje mes Ligës Premierë, Ligës së Kampionëve dhe EFL Cup. Ai do t'i mungojë Liverpoolit në sfidat ndaj Chelseas, RB Leipzigut, Arsenalit, Brightonit, Bayer Leverkusenit, Aston Villa dhe Brightonit në Kupë.

## Kloppi me detyrë të re, emërohet drejtor i Red Bullit

Salzburg, 9 tetor - Jurgen Klopp është padyshim një nga personazhet më karizmatikë të botës së futbollit falë qasjes tepër pozitive me tifozët, lojtarët dhe mediet. Duke qenë një person shumë popullor dhe i dashur, lamtumira e tij në fund të sezonit të shkuar, u prit me lot në sy jo vetëm nga tifozët e Liverpoolit, por edhe nga sportdashësit anembanë globit. Pas sukseseve të jashtëzakonshme me anglezët, timonieri gjerman vendosi t'i ndajë rrugët. Megjithatë, Klopp deklaroi se këtë sezon do t'i dedikojë i gjithi familjes. E përditshmja gjermane “Bild” ditën e sotme ka dhënë lajmin se Kloppi ka pranuar tashmë detyrën e tij të re. Gjermani ka



nënshkruar një kontratë disavjeçare me Red Bull dhe punën do ta nisë më 1 janar 2025. 57-vjeçari do të jetë drejtor i Red Bullit, ku do të ketë nën vëzhgim të gjitha ekipet e kësaj kompanie. Saktësisht, sipas së përditshmes gjermane “Bild”, Klopp do të jetë këshillues për ekipet Leipzig,

Salzburg dhe New York për çështjet e stërvitjeve, filozofinë e lojës, zhvillimin dhe transferimet e talenteve, trajnerëve dhe më gjerë. Ndërkohë në kontratën e nënshkruar me kompaninë Red Bull ka dhe një klauzolë të veçantë që lidhet me kombëtaren gjermane. Sipas gazetës gjermane bëhet me dije se Kloppi mund të largohet nga ky pozicion nëse në të ardhmen do t'i ofrohet mundësia të jetë trajneri kryesor i Gjermanisë, si pasardhës i mundshëm i Julian Nagelsmann. Vetë Kloppi është shprehur shumë i emocionuar dhe entuziast, ku ka theksuar se dëshiron t'iu mbështesë talentet e futbollit. Për të ky është një projekt mjaft ambicioz që do ta marrë të gjithë vëmendjen.

## Dybala mund të largohet nga Roma, kërkohet nga Galatasaray

Paulo Dybala i tha “jo” Arabisë Saudite verën e kaluar, por mund të largohet nga Roma në muajt e ardhshëm. Argjentinasi mund t'i bashkohet Galatasarayt, klub që ka qenë gjithmonë i vëmendshëm ndaj

mundësive që ofron Seria A, për t'iu bërë “yjeve” të këtij kampionati oferta serioze dhe konkrete. Shitja e “Joya” nuk është aspak e pamundur në kryeqytetin italian, por burimet turke shkojnë më tej, flasin për

një takim të planifikuar mes dy klubeve gjatë këtyre ditëve, për ta kuptuar realizueshmërinë e operacionit në janar ose qershor. Kontrata e Dybalas me Romën skadon në fund të sezonit dhe përmban një klauzolë rinovimi,

por ende nuk është planifikuar asgjë në këtë drejtim. Marrëdhënia me verdhekuqtë duket se është përkeqësuar pak javët e fundit për shkak të mungesës së aktivizimit, diçka e pajustificuar me ndonjë dëmtim

të muskujve. Problemet e shumta fizike dhe kontrata e rëndë duket se nuk e shqetësojnë Galatasarayt, gjithmonë i vëmendshëm dhe i mirë në “peshkimin” e Serisë A (i fundit ishte Osimhen).





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

## NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga United Energy Sh.P.K. Rahovec me Aplikues: Laurat Krasniqi me nr. të protokolit 4329/24 të datës 01.07.2024 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet parku solar fotovoltaik dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Zoçishtë dhe Optrushë, me numër të parcelave:

Zona kadastrale Zoçishtë janë: P-71510032-00005-0 ZK; P-71510032-00001-0 dhe Zona Kadastrale Optrushë P-71510056-00001-0, P-71510056-00010-0, P-71510056-00011-0, P-71510056-00012-0, P-71510056-00023-0 me sipërfaqe totale prej 1,720,790 m<sup>2</sup> që ndodhen në Komunën e Rahovecit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Impianti fotovoltaik "Parku Solar United Energy" për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt. 21.10.2024 në: [dkp.mmp@rks-gov.net](mailto:dkp.mmp@rks-gov.net).

### Dokumentet e publikuara:

**Kushtet Ndërtimore të propozuara:** United Energy Sh.P.K. Zoçishtë dhe Optrushë, Rahovec

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual ( format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Mal i klasës 4,5 dhe 6 Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli

b. Vija rregulluese. - m'

c. Vija e ndërtimit. 10 m

d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike 3.5 m

e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës. 3.5 m

f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte 0.65 %

g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. 96.79 %

h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. - %

i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. - %

j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve. 20

k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja: Montuese

l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po  Jo   
Nuk aplikohet

m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth?

Po  Jo  Nuk aplikohet  Sqaro:

n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po  Jo  Nuk aplikohet  Sqaro:



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lavdrim Lakna shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Eglon Afrim Rudi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e kolegjit UBT në prishtinë me nr. 639\45-64.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me

1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Rubixtech” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811880641 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Rubixtech” L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811880641 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Rubixtech” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811880641 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Right Angle” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812072081 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Right Angle” L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812072081 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Right Angle” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 812072081 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

